



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1144 / prot.
12

Tiranë më 11.10.2021

REKOMANDIM

Nr. 49, datë 11.10.2021

PËR KONTROLLUESIN “FED INVEST SHKK”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Fed Invest SHKK” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 124, datë 23.08.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesës nr. 1144 Prot., datë 30.06.2021 të N. Xh. dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi është një shoqëri e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj: “Pranimin e depozitave dhe dhënien e kredive anëtarëve të saj. Me miratimin e BSH mund të ushtrojë veprimtari financiare të tjera si të gjitha shërbimet e pagesave dhe transferimit të parave, këmbim valutor, qiraja financiare, shërbime të tjera financiare”.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës, nga verifikimi i kryer rezultoi se ankuesja N. Xh., nuk është anëtare e institucionit “*Fed Invest SHKK*”, por dorëzues (pra garantor) në kreditë Nr. ALTD-275176-002, dt. 03.10.2017. Në kohën e disbursimit të kredisë rezultoi të jetë nënshkruar prej saj “*Deklarata e Dorëzuesit*”, e cila bashkëlidhur (në faqen e prapme) ka edhe Kushtet e Përgjithshme të Punës.

Në kuadër të ushtrimit të aktivitetit të vet, Kontrolluesi ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me “*Smart Collection SHPK*” (në vijim, “*Përpunuesi*”), me objekt “... *trajtimin dhe mbledhjen e detyrimeve të prapambetura të debitorëve të Fed Invest SHKK... të lindura nga kontratat respektive të huas, të lidhura midis palëve*”.

Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të Përpunuesit, listën e kredi marrësve debitorë (në format elektronik), përfshirë edhe të dhënat e garantorëve respektiv. Nga verifikimi konstatohet se të dhënat e ankueses (në cilësinë e dorëzueses) konsistojnë në kategoritë e të dhënave: *nr. i kontratës, emër, atësi, mbiemër, datëlindje, nr. telefoni dhe adresë*. Kontrolluesi përcjell të dhënat e mësipërme pranë Përpunuesit në rrugë elektronike, për të vijuar me procedurën e mbledhjes së borxhit.

Konstatohet se delegimi i përpunimit të të dhënave sipas objektit të marrëveshjes së bashkëpunimit, nuk është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 20 të ligjit si dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012, mbi “*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Gjithashtu, Kontrolluesi nuk ka verifikuar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale të deleguar pranë Përpunuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19. Përpunuesi nuk ka përmbushur detyrimin ligjor mbi “*Njoftimin*” pranë Zyrës së Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr.19.

3. Kontrolluesi disponon faqen zyrtare <https://www.fedinvest.al>, në të cilën konstatohet të jetë e publikuar rubrika “*Privatësia*”. Nga analizimi i saj, rezultoi se kontrolluesi nuk informon qartësisht subjektet e të dhënave që vizitojnë këtë faqe, për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, kategoritë e të dhënave personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në

internet, ka detyrimin që të publikojë “*Politikat e Privatësisë*”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i “*Politikave të Privatësisë*” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

Gjithashtu, referuar formularëve tip: “*Kërkesës individuale për anëtarësim*”, “*Aplikim për kredi*”, “*Kërkesë për hapje CIF jo anëtar*”, “*Kontratë Kredie*”, etj., konstatohet se subjektet e të dhënave nuk informohen mbi të drejtat që gëzojnë, sipas parashikimeve të nenit 18 të ligjit.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezultoi se Kontrolluesi e ka përmbushur detyrimin për njoftim për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës sipas parashikimeve të nenit 21 të ligjit. Megjithatë, konstatohet se njoftimi nuk është i plotë dhe i saktë dhe për pasojë është e nevojshme të plotësohen deklaratimet në rubrikën 7: “*Marrësi i të dhënave personale*”, sa i përket marrësve drejt të cilëve Kontrolluesi i përhap të dhënat personale në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit/delegimit të përpunimit, të tilla si, por pa u kufizuar:
 - a. “*Smart Collection SHPK*”, për qëllim të “*... trajtimit dhe mbledhjes së detyrimeve të prapambetura të debitorëve të Fed Invest SHKK... të lindura nga kontratat respektive të huas, të lidhura midis palëve.*”.
 - b. Shoqërinë përmbartimore “*Përmbartues Gjyqësor Privat ...*”;
 - c. SiCRED, për qëllim të “*Sigurimit të jetës dhe Shëndetit*”;

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

5. Kontrolluesi ka hartuar rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” por, rezulton se rregullorja është e përgjithshme dhe nuk pasqyron proceset reale të përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të ligjit.

Zyre e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregulloreje të posaçme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasoja të rënda që mund të vijnë për subjektin e të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë

14.09.2018 i Komisionerit, për *“Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të ndërmarrë masa konkrete të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, sipas parashikimit të nenit 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”*, (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizata të akredituara dhe autorizuara sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi mori pjesë në seancë dëgjimore dhe nëpërmjet shkresës nr. 3063/1, datë 20.09.2021, paraqiti pretendimet si më poshtë.

- Lidhur me pikën e dytë të procesverbalit, bëjmë me dije se me shoqërinë *“Smart Collection”* është lidhur Marrëveshje e Bashkëpunimit, e cila ka si aneks të saj *“Deklaratën e Konfidencialitetit”* dhe trajtimin e të dhënave personale në përputhje me Ligjin.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Marrëveshja e Bashkëpunimit nuk është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 20 të ligjit si dhe Udhëzimit nr. 19. Ky fakt është pranuar edhe nga kontrolluesi, i cili në seancën dëgjimore ka konfirmuar se me të gjitha shoqëritë të cilat bashkëpunon do të hartohen kontrata ku të pasqyrohen detyrimet e parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Lidhur me pikën e pestë të procesverbalit, bëjmë me dije se deklarata e privatësisë së të dhënave është publikuar në faqen web të institucionit dhe se përmban informacione të bollshme për këdo që akseson faqen.

Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo deklaratë nuk informon qartësisht subjektet e të dhënave që vizitojnë këtë faqe, për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të

dhënat personale, kategoritë e të dhënave personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit. Ky fakt është pranuar edhe nga kontrolluesi, i cili në seancën dëgjimore ka konfirmuar se do të bëj përditësimin e deklaratës së privatësisë në faqe.

- Lidhur me pikën e gjashtë të procesverbalit, bëjmë me dije se Formulari i Njoftimit është plotësuar duke u mbështetur në udhëzimin e posaçëm të Komisionerit. Hapësira në rubrikën nr. 7 të formularit është shumë e kufizuar dhe për rrjedhojë emërtimet e institucioneve të vendosura janë me akronime.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, nëse hapësira e formularit është e pa mjaftueshme për plotësimin e tij me të gjitha të dhënat, mund ta plotësojë së bashku me një shkresë shoqëruese ku të paraqitet informacioni i plotë.

- Lidhur me pikën e shtatë të procesverbalit, bëjmë me dije se rregullorja jonë e brendshme "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" është përditësuar së fundmi dhe duke i patur të gjitha politikatat TIK të mbledhura në një manual të posaçëm, kemi një paragraf të dedikuar për mbrojtjen e të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se rregullorja e vendosur në dispozicion nga kontrolluesi nuk është e plotë dhe nuk pasqyron proceset reale të përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi, dhe ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47. Ky fakt është pranuar edhe nga kontrolluesi, i cili në seancën dëgjimore ka konfirmuar se është duke marrë konsulencë të specializuar nga shoqëri akredituese, e cila do ti asistojë për plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në Ligj.

Zyra e Komisionerit vlerëson gatishmërinë dhe bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin serioz të tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 20, 21, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa "a/I"), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ndërmarrë hapa konkrete për informimin specifik të subjekteve të të dhënave për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
2. Kontrolluesi të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit përkatës, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të miratuar nga Komisioneri;
3. Kontrolluesi në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të kryejë përditësimin e "Njoftimit", në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
4. Kontrolluesi në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë një rregullore të posaçme, në të cilën të parashikohen masa teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen;
5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
6. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - Brenda 30 ditëve, detyrimin e treguar në pikat 1, 2, 4 më sipër;
 - Në mënyrë të menjëhershme, detyrimet e treguara në pikën 3 më sipër;
 - Brenda 45 ditëve, detyrimin e treguar në pikën 5 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri

vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 11.10.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

